

**atrc.**

QENDRA E TRAJNIMEVE &  
BURIMEVE PER AVOKIM



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA



# THE ADVOCATE

Përkrah Organizatat Jo-qeveritare

Vëllimi V • Numri 6 • Korrik 2007

## PËRMBAJTJA

### Faqe 2

ATRC ka shpallur rundin e gjashtë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim

Qendra Rajonale e Mjedisit u ndihmon OJQ-ve në përpilimin e planeve zhvillimore në të mirë të ambientit

"Kosova të jetë shtet nacional"

### Faqe 3

"Edhe Ne Mund të Punojmë," personat me aftësi të kufizuara ua përkujtojnë shoqërisë dhe autoriteteve

Qytetarët e Prishtinës të pakënaqur me menaxhimin e fondeve publike

"Kosova: Shteti i paprecedencë"

### Faqe 4

Libër i ri për tranzicionin demokratik në Kroaci

Mjaft presionit ndaj lirisë së medias, bën thirrje Lëvizja Mjaft

Biblioteka e ATRC-së

**Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj**

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

Rr. Agim Ramadani Nr. 15  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë  
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

## ATRC ka shtuar shërbimet e trajnimit për të zhvilluar sektorët e shoqërisë civile

Trajnerët dhe konsulentët e ATRC-së kanë realizuar 19 trajnime gjatë vitit 2007 për pesë sektorë të OJQ-ve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të sektorëve të shoqërisë civile në Kosovë. OJQ-të të cilat merren me çështje rinore, shëndetësore, pensionale, me persona me aftësi të kufizuara dhe gratë rome ashkali & egjiptiane (RAE) kanë përfutur nga një sërë trajnimesh të ndryshme.

Një qind a shtatë përfaqësues të OJQ-ve rinore janë trajnuar për menaxhim të projekteve, qeverisje të mirë, menaxhim bazik financiar, dhe avokim & ndërtim koalicioni. Sipas Alban Krasniqit, drejtor i Rrjetit Rinor të Kosovës, këto janë fushat për të cilat sektori i të rinjve ka më së shumti nevojë për t'u trajnuar.

ATRC-ja ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të dhjetë OJQ-ve që merren me çështje shëndetësore. Përfaqësues të këtij sektori kanë ndjekur trajnime për shkrim të projekt propozimeve, dhe hyrje në avokim & ndërtim koalicioni. Kon-

sulenca individuale janë ofruar në bazë të kërkesave të organizatave të trajnuara.

ATRC-ja ka identifikuar organizatat e pensionistëve si një ndër sektorët më të rëndësishëm të shoqërisë civile. Përmes planifikimit strategjik të punës së 2 shoqatave të pensionistëve, ATRC-ja ka inicuar ndërtim institucional për këtë sektor më qëllim të përkrahjes së organizatave pensioniste për t'u bërë sektor i organizuar, i besueshëm dhe zë më i efektshëm për reformim pensional përmes veprimeve të bashkërenduara.

Rrjeti i Grave të komunitetit RAE është sektor tjetër i shoqërisë civile, të cilin ATRC-ja e ka përkrahur në ngritje të kapaciteteve organizative përmes trajnimeve për shkrim të projekt propozimeve, rolin e OJQ-ve në shoqërinë civile, monitorim dhe vlerësim, qe-



Sesion trajnimi në qytetin e Gjakovës më 31 maj

risje të mirë, menaxhim bazik financiar, dhe avokim & rrjetëzim.

Në qershor, ekipi i trajnerëve ka filluar të punoj me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës në përgjigje të nevojës së shoqatës për të përpiluar strategjinë e punës dhe shkruar projekt propozim.

ATRC-ja do të vazhdojë të përkrah sektorët e OJQ-ve përmes trajnimeve dhe konsulencave bazike dhe të avancuara në fushat e zhvillimit organizativ të OJQ-ve, menaxhim, avokim dhe ngritje fondesh.

Për më shumë informata, kontaktoni [training@advocacy-center.org](mailto:training@advocacy-center.org)

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

## Forumi 2015

**"Kosova të jetë shtet nacional"**

"Forumi 2015" ka organizuar simpozium më 26 qershor për të diskutuar identitetin evropian të Kosovës. Qëllimi i simpoziumit ka qenë edhe diskutimi për nocionet: komb, popull, shtet, shtetësi, etj. Panelistët kanë qenë ekspertë vendor dhe ndërkombëtar të çështjeve të identitetit. "Duke pasur parasysh shumicën shqiptare, Kosova duhet të jetë shtet nacional, e jo siç është Bosnja", ka thënë profesori Paul Garde, ekspert i çështjeve të Ballkanit.

Muhamet Mustafa, përfaqësues i Forumit 2015, ka theksuar se Kosova tashmë ka identitetin evropian, jo vetëm për shkak të pozitës gjeografike por edhe për shkak të fakteve kulturore dhe sociale sot dhe në të kaluarën, perceptimit të qytetarëve dhe vizionit për të ardhmen.

"Përfshirja e Kosovës në hartën politike të Evropës do t'i kontribuonte identitetit të saj evropian", kanë potencuar panelistët.

Përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, mediave dhe ekspertë universiteti kanë qenë pjesëmarrës të simpoziumit.

"Forumi 2015" është koalicion i Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur - Soros dhe Institutit Riinvest, i cili synon bashkërendimin e aktiviteteve të shoqërisë civile në Kosovë drejt integritimit Euro-Atlantik.

*Për më shumë informata, kontaktoni: riinvest@riinvestinstitute.org*

**Mundësi financimi për OJQ-të****ATRC ka shpallur rundin e gjashtë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim**

ATRC ka shpallur më 19 korrik konkurs për OJQ-të kosovare për rundin e gjashtë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile të IREX-it.

Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim do t'u ndahen OJQ-ve, projekt-propozimet e të cilave përmbajnë komponentë partneriteti dhe rrjetëzimi ndërmjet OJQ-ve, OJQ-ve dhe sektorëve të tjerë (qeveria lokale ose qendrore, bizneset private). Projektet po ashtu duhet të adresojnë çështje të rëndësishme në njërin prej këtyre tri fushave: transparenca dhe anti-korrupsioni, zhvillimi i komunitetit ose pajtimi ndë-

retnik, dhe zgjidhja e konfliktit. Kohëzgjatja e këtyre granteve është 6 muaj. OJQ-të mund të aplikojnë për grant deri në \$ 18,000. *Afati i fundit për dorëzim të projekteve është 3 gushti, 2007.*

Dokumentet gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të konkursit (përfshirë përshkrimin e programit, kriteret e ndarjes së granteve, afatet kohore për aplikim, kriteret e përzgjedhjes dhe procesi i shqyrtimit, format e kërkuara për aplikim si dhe formati dhe udhëzuesi i propozimit) mund të merren në ATRC, rruga Agim Ramadani, Nr.15, Prishtinë ose të shkarkohen nga faqja e Internetit e

ATRC-së [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org).

Programi Kosovar për Shoqëri Civile (KCSP) është iniciativë trevjeçare e financuar nga USAID dhe e realizuar nga IREX. Qëllimi i programit është zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë civile dhe komunitetit të OJQ-ve në Kosovë, që të jetë sektor i qëndrueshëm dhe të luaj rol domethënës në përfaqësimin e dallimeve qytetare si dhe në formulimin e politikave publike.

*Për më shumë informata, kontaktoni 038 244 810 ose [grants@advocacy-center.org](mailto:grants@advocacy-center.org).*

**Qendra Rajonale e Mjedisit u ndihmon OJQ-ve në përpilimin e planeve zhvillimore në të mirë të ambientit**


Përfaqësues të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) në Prishtinë i kanë informuar OJQ-të vendore për projektin e tyre të ri "Kosova e qëndrueshme: ngritje e kapaciteteve të shoqërisë civile mjedisore", gjatë një takimi informativ të organizuar nga ATRC-ja më 13 korrik.

Projekti ka për qëllim të ofroj trajnime për OJQ-të që

merren me çështje mjedisore në Kosovë për të krijuar një lëvizje bashkëpunimi, vitale dhe kritike, e aftë të ndihmojë në rindërtimin socio-ekonomik dhe në përpilimin e planeve zhvillimore që nuk dëmtojnë ambientin.

Zeqir Veselaj, përfaqësues i REC-it në Prishtinë veçoi objektivat e projektit, aktivitetet, rezultatet e pritura, si dhe mundësitë që i ofrohen OJQ-ve mjedisore për trajnime, fushata të vetëdijesimit publik, dhe vizitat studimore jashtë Kosovës. Projekti do të zgjas 3 vjet.

*Për më shumë informata, kontaktoni [info@kos.rec.org](mailto:info@kos.rec.org)*



*Zyra e Qendrës Rajonale të Mjedisit në Kosovë punon për zhvillim dhe ngritje kapacitësh të shoqërisë civile, bërje të politikave mjedisore, bujqësi ekologjike, inxhinieri mjedisore (kualitet të ajrit), menaxhim të mbeturinave (parandalim dhe riciklim), plan mjedisor veprimi në nivel lokal, praktika zhvillimore të qëndrueshme, dhe informim*

## Publikim i ri

**"Kosova: Shteti i paprecedencë"**

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) ka publikuar në korrik punim të ri, të titulluar "Kosova: Shteti i paprecedencë".

Publikimi përmban informata mbi spastrimin etnik dhe tentim gjenocidi, shpërbërjen e shtetit të përbashkët, revokimin e paligjshëm të statusit të Kosovës, territorin e përkufizuar qartë me kufij të dallueshëm, vullnetin e shumicës për t'u ndarë, statusin e hapur nën protektorat ndërkombëtar, kapacitetin demokratik të udhëheqjes së vendit...

"Ky punim shtjellon argumentet për rrugëtimin e Kosovës drejt pavarësisë si një rast unik, që rrjedhimisht i mundësojnë Kosovës për t'u pavarësuar pa e cenuar të drejtën ndërkombëtare. Në këtë drejtim, punimi prezanton një sërë argumentesh si nga dinamika politike e veçantë që solli Kosovën deri në gjendjen e saj të sotme, e drejta ligjore dhe morale e saj si ish-njësi federale për t'u ndarë nga ish Jugosllavia, tentimi i gjenocidit dhe trajtimi i vazhdueshëm brutal i shumicës shqiptare gjatë dekadave", thuhet në publikim. "Për shumicën e analistëve, dilema më nuk është se a do të pavarësohet Kosova, por se kur dhe si do të ndodhë kjo".

Publikimin mund ta lexoni në [www.kipred.net](http://www.kipred.net)

**"Edhe Ne Mund të Punojmë," personat me aftësi të kufizuara ua përkujtojnë shoqërisë dhe autoriteteve**

Shoqata e personave me aftësi të kufizuara "HandiKos" ka inicuar debat në tërë Kosovën mbi të drejtën e punësimit të këtyre qytetarëve për t'iu përkujtuar shoqërisë dhe vendim-marrësve se "edhe ata mund të punojnë".

HandiKos ka organizuar 14 tryeza të rrumbullakëta në shtatë rajone të Kosovës gjatë muajve shkurt - qershor 2007 fokusuar në infrastrukturën ligjore që ka të bëjë me personat me aftësi të kufizuara, dhe në procedurat administrative për punësimin e tyre.

Takimet rezultuan me disa rekomandime të cilat HandiKos i prezantoi më 21 qershor në tryezën e mbajtur në Prishtinë, ku morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve lokale dhe qendrore, dhe sektorit të biznesit.



"Punësimi i personave me aftësi të kufizuara nuk duhet të konsiderohet nevojë sociale. Qytetarët me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësi të njëjta punësimi bazuar në aftësitë e tyre profesionale", ka deklaruar Halit Ferizi, drejtor i HandiKosit. Pjesëmarrësit kanë kritikuar qasjen e qeverisë, duke theksuar se institucionet qeverisëse janë të

gatshme të dëgjojnë por jo edhe t'i pranojnë sugjerimet nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara. "Perceptimi publik ndaj personave me aftësi të kufizuara është negativ dhe nuk ka vullnet në mesin e punëdhënësve për të punësuar këtë grup të qytetarëve", kanë shtuar ata.

Nuk ekziston ndonjë Plan Veprimi ose Strategji në nivel lokal, rajonal ose kombëtar për t'u marrë me çështjet e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në sektorin privat ose atë publik... thuhet në rekomandimet. Për dokumentin e plotë, kontaktoni [Handikos-prishtine-038@hotmail.com](mailto:Handikos-prishtine-038@hotmail.com)

ATRC ka përkrahur këtë iniciativë në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile IREX, financuar nga USAID.

**Hulumtim nga OJQ****Qytetarët e Prishtinës të pakënaqur me menaxhimin e fondeve publike**

Qytetarët e Prishtinës kanë porositur zyrtarët komunal të punojnë për interesat e qytetarëve, sipas një hulumtimi të OJQ-së "Mileniumi i Ri"

Shumica e qytetarëve të Prishtinës nuk janë të kënaqur me menaxhimin e fondeve publike në qytetin e tyre dhe me punën e Asamblesë Komunale. Ky është rezultati i hulumtimit të kryer nga OJQ Mileniumi

e projektit "Besueshmëria e Qytetarëve në Kuvendin Komunal të Prishtinës", përkrahur nga ATRC dhe IREX.

28.3 % e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur me shërbimet adminis-

trative të komunës, ndërsa 56.7 % janë pjesërisht të kënaqur, thuhet në rezultatin e hulumtimit të Mileniumit të Ri.

Anketa ka përfshirë disa rekomandime nga qytetarët, të cilët u kanë bërë thirrje zyrtarëve komunal që të punojnë për qytetarë e jo për interesa individuale, të jenë transparent për atë çfarë bëjnë, parandalojnë korrupsionin, ndalojnë ndërtime pa leje dhe ndërrojnë stafin menaxhues.

Për më shumë informata, kontaktoni: [ojqmileniumi@yahoo.com](mailto:ojqmileniumi@yahoo.com)


**atrc****Executive Director**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org**Financial & Administration  
Manager**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org**Grant Manager**  
KUSHTRIM KALOSHI  
kushtrimk@advocacy-center.org**Grant Officer**  
XHAFER AHMETI  
xhafer@advocacy-center.org**Grant Officer**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org**Grant Finance Manager**  
SAFETA XHEKOVIQ  
safeta@advocacy-center.org**Training & Consultancy  
Services Manager**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
NORA SUSURI  
nora@advocacy-center.org**Communication & Outreach  
Manager**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org**IT and Database Manager**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org

## Zhvillime rajonale të shoqërisë civile

### Libër i ri për tranzicionin demokratik në Kroaci

Me rënien e komunizmit dhe vdekjen e Jugosllavisë, shtetet pasuese janë ballafaquar me sfida historike për të krijuar demokraci të ndara, moderne nga ish shtetet autoritare. Në qendër të përvojës kroate ka qenë çështja e nacionalizmit dhe a duhet që shteti kroat të definohet si shtet i qytetarëve (me të drejta të barabarta për të gjitha grupet nacionale) ose shtet nacional i kroatëve (duke privilegjuar kulturën dhe gjuhën kroate, por me një sistem dedikuar edhe anëtarëve të minoriteteve kombëtare).

Sabrina Ramet, profesore e shkencave politike në Universitetin Norvegjez të Shkencës dhe Teknologjisë, dhe Davorka Mati, kryesuese e departamentit të sociologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Zagrebit, kanë mbledhur një sërë studimesh të studiuësve të rëndësishëm për të analizuar zhvillimin e Kroacisë pas komunizmit dhe luftës, në një libër të ri të publikuar më 25 qershor të quajtur "Tranzicioni Demokratik në Kroaci: Transformimi i Vlerave, Arsimit, dhe Mediat".



Për më shumë informata:  
<http://www.tamu.edu/upress/BOOKS/2007/rametcroatia.htm>

Burimi: Balkan Academic News

## Shqipëria

### Mjaft presionit ndaj lirisë së medias, bën thirrje Lëvizja Mjaft

Lëvizja "Mjaft" ka dënuar "presionin e qeverisë shqiptare ndaj shprehjes së lirë" përmes një njoftimi për media, të publikuar më 17 korrik.

"Lëvizja dënon gjobën po-

litike që Qeveria ka vendosur ndaj televizionit Top Channel dhe kërkon anulim të menjëhershëm të saj", thuhet në njoftim.

"Ne përkrahim të drejtën e shprehjes së lirë dhe me-

dian e lirë në Shqipëri, duke e konsideruar atë një ndër shtyllat kryesore të shoqërisë...

Për më shumë informata, vizitoni: [www.mjaft.org](http://www.mjaft.org)



Rreth 50.000 qytetarë shqiptarë kanë protestuar në Tiranë kundër presionit të Qeverisë ndaj medias, në një protestë paqësore të organizuar nga lëvizja "Mjaft" në muajin prill

## Biblioteka e ATRC-së

Biblioteka e ATRC-së është pasuruar me 194 tituj të rinj në muajin korrik. Në tërësi, biblioteka përmban 994 tituj librash, raportesh, dhe materiale të tjera për avokim, shoqëri civile, lidhshmëri, vetëdijesim gjinor, të drejta të njeriut, etj. OJQ-të kosovare dhe ato ndërkombëtare, studentë universiteti, gazetarë, zyrtarë qeveritarë dhe qytetarë të interesuar mund të kenë qasje në bibliotekë.

Lexuesit kanë qasje online në databazën e bibliotekës në [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org) (shtyp shërbimet) për të parë listën e plotë me të gjithë titujt.

